## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Për: **MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM**
Për Aktivitetin e Prokurimit:

| | |
|---|---|
| **Nr i prokurimit** | **211-22-2472-2-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | **MKK-211/22/003/221** |

Sa i përket tenderit për: **"Sigurimi fizik i objektit te MKK-se"**

## ANKESË

**1. Identifikimi i ankuesit:**

**MEB L.L.C**
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*
***Rr. Edit Durham 213A***
*(Adresa)*
***Prizren*** ***20000***
*(Vendi)* *(Kodi postar)*
***049 500 190***
*(Numri Telefonit)* *(Numri i Faks-it)*
***Sefçet A. Damka***
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*
***Meb.llc1@gmail.com***
*(Adresa elektronike)*
***02.06.2022***
*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

Sefçet A. Damka

MEB. L.L.C.
Rr. Edit Durhan 213 A
PRIZREN KOSOVA
Mob.: +383-49-500-190
Tel.: +383-29-220-025
info: meb.llc1@gmail.com

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

**2. Identifikimi i avokatit**

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm[1] ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

_____
*(Emri i avokatit)*

_____
*(Adresa e plotë)*

_____ _____
*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

_____
*(Adresa elektronike)*

_____ _____
*(Data e parashtrimit të ankesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

[1] Kjo ankesë është përgatitur vet.

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

*Formulari B05 – Njoftimi për kontratë me datë 28.03.2022*
*Dosja e tenderit dhe përshkrimi i çmimit – e publikuar me datë 29.03.2022*
*Formulari B58 – Njoftimi mbi vendimin e AK me datë 27.04.2022*

*Autoriteti ka publikuar 3 herë Njoftimin mbi vendimin e AK – Formulari B58*

- *Njoftimi mbi vendimin – 27.04.2022*
- *Njoftimi mbi vendimin – 04.05.2022*
- *Njoftimi mbi vendimin – 17.05.2022*

*Duke respektuar afatet kohore kam ngritur Kërkesë për rishqyrtim me datë 22.05.2022, për njoftimin e datës 17.05.2022.*

***Me datë 24.05.2022 kam pranuar Vendimin mbi shqyrtimin e ankeses sime të dates 22.05.2022, ku duke respektuar Nenin 109 të LPP-së po ngrisë ankesen time pranë OSHP-së.***

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒

Ky formular mungon në platëformë.

MEB. L.L.C.
Rr: Edit Durhan 213 A
PRIZREN KOSOVA
Mob.: +383-49-500-190
Tel. :+383-29-220-025
info: meb.llc1@gmail.com

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** ☒ **Jo** ☐

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** ☒ **Jo** ☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.*

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Shkeljet në Ligjin e Prokurimit publik:**

Neni 1. **Qëllimi, Fushëveprimi, Përjashtimet, Përkufizimet**
Neni 7. **Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca**
Neni 11. **Informatat Sekrete Afariste**
Neni 17. **Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Shërbime**
Neni 28. **Specifikimet teknike**
Neni 29. **Variantet e Specifikimeve teknike**
Neni 57. **Sigurimi i tenderit**
Neni 60. **Kriteret për dhënien e kontratës**
Neni 64. **Dështmitë e kërksave.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

**8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

**Faktet dhe argumentet për shkeljet në procedurë:**

Neni 1. **Qëllimi, Fushëveprimi, Përjashtimet, Përkufizimet**

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

- **Pretendimi 1:** Autoriteti Kontraktues – MKK përmes njoftimeve mbi vendimin e AK të datës 17.05.2022 nuk e ka respektuar Nenin 1 të LPP, ku theksohet që do të sigurojë që në mënyrë efikase dhe transpartente të shfrytëzojë fondet publike. Përmes këtij njoftimi dhe qasjen në dokumente zyrtare. **AK-MKK ka shkelur parimin e transparencës dhe efikasitetit duke mos ofruar asnjë dokument në lidhje me Grupin e Operatoreve Ekonomik përfitues.**

**Neni 7. Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca**

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-di skriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

- **Pretendimi 2:** Në pikën 1 të Nenit 7, theksohet fare qartë se AK do t'i trajtoje të

MEB. L.L.C.
Rr: Edit Durhan 213 A
PRIZREN KOSOVA
Mob.: +383-49-500-190
Tel. :+383-29-220-025
info: meb.llc1@gmail.com

gjithë operatoret ekonomik në menyrë të barabartë dhe jo diskrimunes dhe të veprojë në mënyrë transparente. Këtu si Operator Ekonomik pjesëmarrës në procedurë mendojmë se janë shkelur tri shtyllat kryesore te ketij neni nga ana e Autoritetit Kontraktues. Ku per tri here me radh eshte shpallur fitues nje Grup i Operatoreve Ekonomik ku ne si konkurent te tregut me ta nuk kemi asnje qasje ne dokumentet e tyre.

**Neni 11. Informatat Sekrete Afariste**

1. Pa prejudikuar detyrimin për t'u siguruar palëve të interesuara dhe publikut qasje në shënimet e aktiviteteve të tij të prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të respektojë dhe të mbajë si sekret informatat e klasifikuara si informata sekrete afariste në përputhshmëri me këtë nen.

- **Pretendimi 3:** Autoriteti Kontraktues shkele Nenin 11, duke e kombinuar me Nenin 68 dhe 69. Si operator Ekonomik theksojme qe nuk eshte respektuar Neni 11 per keto arsyeje. Në dosjen e tenderit, kërkohen këto dokumente:
    1. Certifikata e regjistrimit të biznesit – **Dokument publik**
    2. Certifikata e regjistrimit të TVSH-së – **Dokument publik**
    3. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë e lëshuar nga MPB – **Dokument publik**
    4. Licenca e frekuencave për sistemin e radio komunikimit, lëshuar nga ARKEP – **Dokument publik.**

Si ka mundësi të klasifikohen këto 4 dokumente zyrtare të lëshuara nga Autoritetet Publike si dokumente sekrete. Qëllimi jonë kryesor si Operator të Interesuar është t'i analizojmë këto dokumente se a janë në përputhje me dëshmitë e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe dy licencat të analizohen për afatin e validitetit.

**Neni 57. Sigurimi i tenderit**

1. Gjatë një aktiviteti të prokurimit që shpie drejt dhënies së një kontrate me vlerë të mesme ose të madhe, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit që të depozitojnë siguri (garantim) për tender. Siguria e tenderit që është depozituar nga tenderuesi do të konfiskohet.

- **Pretendimi 4.** Pse duhet të llogaritet dokument sekret, sigurimi i tenderit i përcaktuar në Dosjen e Tenderit, kur dihet që nëse ky kriter nuk është nen validitetin e kërkuar dhe mbulueshmerinë financiare të kërkuara shpallë në mënyrë automtike si Ofertë të Papërgjegjshme.

**Neni 64. Dëshmitë e kërksave**

Një kandidat ose tenderues do të dëshmoj me certifikatë, vërtetim apo dëshmi të tjera të mjaftueshme të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues që: (i) arsyet për mos-kualifikim sipas nenit 65 të këtij ligji nuk zbatohen; (ii) të verifikojë përshtatshmërinë e tij profesionale, siç kërkohet nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 66 të këtij ligji; (iii) i plotësojnë kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 68-71 të këtij ligji.

- **Pretendimi 5.** Autoriteti Kontraktues shkel nenin 11 duke e kombinuar me Nenin 64, ku në kërkesën tonë për qasje në dokumente zyrtare nuk paraqiten dokumentet:
    1. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e Kosovës e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit. Duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës – **Dokument publik**
    2. Vërtetimin nga Gjykata themelore – **Dokument publik**

Këto dy dokumente duhet të dergohen për dy operatoret ekonomik të konzorciumit, asnjeri nuk na është dorëzuar nga ana e AK-MKK.

MEB. L.L.C.
Rr: Edit Durhan 213 A
PRIZREN KOSOVA
Mob.: +383-49-500-190
Tel. :+383-29-220-025
info: meb.llc1@gmail.com

**Neni 17. Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Shërbime, Neni 28. Specifikimet teknike dhe Neni 29. Variantet e Specifikimeve teknike:**

1. Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për shërbime është e barabartë me pagesën e përgjithshme dhe shumat e kompensueshme që do të paguhen nga autoriteti kontraktues sipas kontratës, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, duke pasur parasysh dispozitat e këtij neni. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar për shërbime, autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për shërbimet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, detyrimet dhe tarifat e tjera.

- **Pretendimi 6.** Bazuar në specifikimet e detyrueshme teknike, Autoriteti Kontraktues Ministria për Kthim dhe Komunitete nuk ka respektuar piken 1 te nenit 17, duke mos i perfshire të gjitha elementet që qojnë të çmimi përfundimtare. Përmes këtij pretendimi si Operator Ekonomik pjesëmarrës në Procedurë nderlidhimin edhe Nenin 28 dhe 29 të LPP që kanë të bejnë me specifikimet teknike dhe variantet e specifikimeve teknike dhe shkeljet bazike mbi Ligjin e Punës në Kosovë. Shembull detal:

Kërkohet qe mbikqyrja e objektit duhet te jete 24h pa ndërprerë, duhet te jente te angazhuar 4 punetore, gjate orarit te punes nga ora 8:00 deri 16:00 duhet te jene te angazhuar dy (2)punetore.

- 4 punëtor për 24h (ku dy prej tyre punojnë në ndrrimin e njejt), këtu kemi të bëjmë me 8 orë pune në ditë dhe duke e ditur që kërkohet me sistemin 24/7 kemi të bejme me 8h*7=56 orë pune në jave, kur dihet që me Ligjin e Punës mbulueshmeria e punëve është 40 orë në javë me mundësi të punës shtesë jo me shumë se 40 orë tjera në muaj. Në këtë rast nese analizojmë sistemin e oreve të punës 8*30(31)=240 orë punë e në disa rasta edhe 248 orë punë (këtu kjo llogaritje parashihet edhe me oret totale të përcaktuara 8929 ore pune totale / 12 muaj / 3 punëtor është 248 orë pune në muaj) e e cila shkel Ligjin e Punës (merrni informacionet konkrete).

**LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS:**

Neni 20 Përcaktimi i orarit të punës 1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore, gjatë së cilës i punësuari kryen punë ose shërbime në të mirë të punëdhënësit. 2. Orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe. 3. Orari i plotë i punës për të punësuarin, i cili është më i ri se tetëmbëdhjetë (18) vjeç, nuk mund të jetë më shumë se tridhjetë (30) orë në javë.

Neni 23. Puna më e gjatë se orari i plotë i punës 1. Në raste të jashtëzakonshme, me rritjen e vëllimit të punëve dhe në raste të tjera të domosdoshme, me kërkesën e punëdhënësit, punëtori duhet të punojë me gjatë se orari i punës (puna jashtë orarit), më së shumti deri në tetë (8) orë në javë. Pika 8 e nenit 23, theksohen edhe këto detaje: Inspektori i Punës ndalon punën jashtë orarit, nëse ajo ndikon dëmshëm në shëndetin dhe aftësinë punuese të të punësuarit.

Si Operator Ekonomik pjesëmarrës theksojme qe ketu kemi te bejme me nje pune shtese shume te ngarkuar andaj edhe nuk kemi mundesi te ngarkeses te cilat nuk respektohen me dispzitat ligjore ne Kosovë.

**Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës**

1. Autoriteti kontraktues do të përcaktojë në dosjen e tenderit nëse kontrata publike do t'i jepet: 1.1. tenderuesit që ka dorëzuar tender të përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

- **Pretendimi 7.** Si Operator Ekonomik nuk kemi marrë asnjë dokument i cili na bind



MEB. L.L.C.
Rr: Edit Durhan 213 A
PRIZREN KOSOVA
Mob.: +383-49-500-190
Tel.: +383-29-220-025
info. meb.llc1@gmail.com

që Grupi i Operatoreve Ekonomik të përzgjedhur nga ana e juaj si Autoritet është i përgjithshëm dhe ka çmimin me të ulët, këtu shkelet edhe Neni 58, ku Autoriteti konktraktues nuk ka bashkangjitur asnjehere Formularin e Procesverbalit të Hapjës dhe ne si Operator Ekonomiki nuk kemi parë përshkrimin e çmimit nese në të nuk ka intervenime, ka gabime aritmetikore ose të ngjashme.

**Autoriteti Kontraktues – Ministria për Komunitete dhe Kthim ne trajtimin e vendimit 24.05.2022, nuk e trajton plotësisht kërkesën tonë per rishqyrtim, ku se bashku trajton pretendimin 1,2,3,4 dhe 5 trajton kërkesën në menyrë të manget dhe duke mos u mbeshtetur në asnje Nen as të LPP as të RRUOPP.** Analizoni sqarimet nga ana e AK-MKK-së:

Pretendimi 1. AK ju ka lejuar te keni qasje ne dokumentet zyrtare si dhe ju kemi ofruar dokumete me veti te cilat i keni kerkuar ju si OE.

Pretendimi 2,3,4,5,. Ju si OE keni kerkuar te keni qasje vetem ne kontrata dhe referencat e OE dhe jo ne dokumente tjera te cilat I keni cekuar ne Pretendimet 2,3,4,5 , ku ne ju kemi treguar qe ato dokumente OE i rekomadnuar per kontrate i ka cilesuar si sekrete afariste. Juve ju eshte dhene kopje dokumenti ne te cilin OE i ka caktuar keto dokumente si sekret afarist.

**Autoriteti Kontraktues – Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk e trajton fare pretendimin tonë të 6, ku vetem jep udhezime se cilat kanë qënë hapat qe ne si OE është dashur t'i respektojmë.**

- Autoriteti Kontraktues – Ministria për Komunitete dhe Kthim shkel ne menyre direkte Neni 17. Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Shërbime, Neni 28. Specifikimet teknike dhe Neni 29. Variantet e Specifikimeve teknike.

**Autoriteti Kontraktues – Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk e trajton fare shkeljet e LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS dhe Nenit 20, 23 dhe pika 23.8 e cila nderlidhet me shkeljet e nenit 17, 28 dhe 29 të LPP-së.**

**Autoriteti Kontraktues – Ministria për Komunitete dhe Kthim në pretendimin 7.** nuk jep asnje detaj për procesverbalin e hapjes i cili as sot nuk eshte ne platformen elektronike (të bashkangjitur gjeni Screen se cfare ne te vertet shfaqet ne kete procedure.




MEB. L.L.C.
Rr: Edit Durhan 213 A
PRIZREN KOSOVA
Mob.: +383-49-500-190
Tel. :+383-29-220-025
info: meb.llc1@gmail.com

**Propozimet për vendim:**

- Aprovohet si e bazuar ANKESA pranë OSHP-së.
- Eksperti shqyrtues raporton për shkeljet në proceduren nga AK-MKK.
- Lënda kthehet në rivlerësim ose anulohet si Procedurë, pasi që ka shkelur Ligjin e Punës dhe duhet intervenime në Specifikimet teknike nga AK-MKK dhe një vargë shkelje tjera të Ligjit të Prokurimit Publik.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Në këtë fazë nuk kemi të shkaktuara deme financiare.**
**Demet jane kohore dhe angazhimin e stafit.**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

1. **Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 17.05.2022**
2. **Vetem dy dokumente nga qasja në dokumente zyrtare (Konfidencialiteti)**
3. **Kërkesa për rishqyrtim nga MEB LLC**
4. **Vendimin e shqyrtimit të ankeses nga AK-MKK të datës 24.05.2022**
5. **Pagesa e takses për ankesë pranë OSHP-së.**

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

MEB. L.L.C.
Rr: Edit Durhan 213 A
PRIZREN KOSOVA
Mob.: +383-49-500-190
Tel. :+383-29-220-025
info: meb.llc1@gmail.com